


VEJORTI ESHTË I PLOTËQISHEM  
GJYKËSIE DRYGËSHË  
KARAR KESHILLOR  
TA THEMELORE / OBNDAH DUD / ASLIVE NIKRAT  
PRIZREN II PRIZREN - PRIZRENE

01.02.2018



P.nr.1891/2017

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm ,përmes gjyqtares Vjollca Bushala, me sekretarën juridike Drita Baftjari, në lëndën penale ndaj te akuzuarit D. G nga fshati H e Q ,Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi,kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1894-3/2017 të dt.03.10.2017,të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit Elfete Purova,pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik , me daten 23.11.2017 ,mori dhe publikisht shpalli ,ndërsa ,me datën. 23.11.2017, e perpilojë me shkrim këtë:

### AKT GJYKIM

#### I akuzuari:

D. G ,nga i ati F dhe e ëma M ,e lindur K i lind. me , në fshatin H e Q ,Komuna e Prizrenit ,ku edhe tani jeton , i martuar , punëtor krahu, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas i Republikës së Kosovës.

#### ËSHTË FAJTOR

Se më dt.07.07.2017, fshatin H e Q ,Komuna e Prizrenit, pikërisht në shtëpinë e tij familjare,mban në pronësi,kontroll ose posedim armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që gjatë bastisjes së shtëpis së të pandehurit,në dhomën e fjetjes është gjetur një armë-pistoletë e llojit ECOL SPECIAL 99 mm.P.A me numer serok EV-1291746 si dhe 19 fishek të kalibrit të panjohur ,duke vepruar në kundërshtim me ligjin e zbatuar për armët.


Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi,kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KP-së.

Andaj ,gjykata,në bazë te neneve 7,8,9,10,21, 41,50, 51 ,52 ,73 dhe 74 të KP-së dhe neneve 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës penale, te akuzuarit i shqipton :

#### DENIM ME KUSHT

Ashtu që i caktohet dënimi me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do te ekzekutohet,nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) vite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,nuk kryen veprë tjetër penale.

#### DËNIM PLOTËSUES



Në nenin neni 374 paragrafi 1 të KP-së, është parashikuar „kushdo që mban në pronësi, kontroll ose posedim armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla ,dënohet me gjobë deri në shtatmijë e pesqind ( 7500 ) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Duke u bazuar ne këto që u cekën me lartë, gjyqtari gjykues ka vendosur që të akuzuarin, ta shpall fajtor për kryerjen e veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KP-së, ngase veprimet e tij i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre dhe së për te njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KP-së ,me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, gjyqtari gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit. Në veqanti ,me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht është marrë për bazë përveq rrethanave të shënuara më poshtë, edhe fakti se prokurori i shtetit gjatë seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, ka propozuar që për shkak të gjendjes së dobët ekonomike ,është i pa punë ,atëherë, ndaj tij të shqiptohet ndonjë dënim alternativ. Përveq kësaj, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin , gjyqtari gjykues e ka marrë pranimin e fajësis nga ana e të akuzuarit, pendimin e tij të thell për kryerjen e veprës penale, duke shtuar se pistoletën në fjalë e kishte gjetur në fushën e quajtur „ T... „, dhe pa menduar fare e ka marrë në shtëpi, asnjë herë nuk e ka përdorur dhe as që dinë ta përdor, andaj dhe ka garantuar se në të ardhmen nuk do të bide ndesh me ligjin. Ndërsa gjyqtari gjykues, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të akuzuarin.

Sipas bindjes së gjyqtarit gjykues, denimi me kusht ndaj të akuzuarit, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë ,në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.


Gjyqtari gjykues, gjithashtu ka konstatauar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit ,nga neni 41 të KP-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### DËNIM PLOTËSUES

Përveq dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 62 par 2 pika 2.6 ,69 dhe 374 paragrafi 3 të KP-së, ndaj të akuzuarit D. G. , shqiptohet edhe dënim plotësues marrja – konfiskimi i revoles , armë-pistoletë e llojit ECOL SPECIAL 99 mm.P.A me numer serok EV-1291746 si dhe 19 fishek të kalibrit të panjohur.

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj qështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit gjyqtari gjykues, duke u bazuar në nenin ,451 paragrafi 1 të KPP-se ,ka vendosur që të i akuzuarin ta detyrojë për të paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .



Në pajtim me dispozitën e nenit 374 par.3 prej të akuzuarit konfiskohet arma e zjarrit,edhe atë një armë-pistoletë e llojit ECOL SPECIAL 99 mm.P.A me numer serok EV-1291746 si dhe 19 fishek të kalibrit të panjohur ,si mjete i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet e procedurës penale , ne emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 euro, ne afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.1894-3/2017 të dt.03.10.2017, ndaj te akuzuarit D \_\_\_\_\_G\_\_\_\_\_ nga fshati H \_\_\_\_\_ e Q \_\_\_\_\_,Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi,kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KP-së .


Prokurori i Shtetit në fjalën e vet ka theksuar se pasi i akuzuari ka pranuar fajësinë,i cili pranim mbështetet në provat të siguruara në mënyr të ligjshme,nuk e kundërshton pranimin e fajësisë,andaq propozon që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit,por gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin,gjykata të merrë parasysh rrethanat lehtësuese në anën e tij dhe atë pranimi i fajësis, ,sjellje korrekte të tijqë ka pasur gjatëgjithë procedures.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë për vepren penale me të akuzohet sipas dispozitivit të aktakuzës duke shtuar se pistoleten në fjalë e kishte gjetur në fushën e quajtur ,, Tallanic,, dhe pa menduar fare e ka marrë në shtëpi, është i gjendjes së rënd ekonomike ,ndihej tejet i penduar për veprimin e bërë dhe garantoj se në të ardhmen nuk do të bjen ndesh me ligjin.

Duke pasur parashysh se në shqyrtimin fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësin për vepren penale per të cilën akuzohet me aktakuzën PP/II.nr.1894-3/2017 të dt.03.10.2017 ,në bazë të nenit 248 të KPP-së,gjyqtari gjykues, pas dëgjimit të palëve ,ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësis,ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë.Në këtë aspekt gjyqtari gjykues ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësis, se pranimi i fajësis është bërë vullnetarisht nga i akuzuari,se pranimit të fajësis mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.



Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari gjykues e ka vërtetuara këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari D \_\_\_\_\_ G \_\_\_\_\_ me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi,kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KP-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësis nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.




**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1891/2017 te dt.23.11.2017**

Sekretarja juridike  
**Drita Baftjari**



Gjyqtarja  
**Vjollca Buzhala**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pak e shfaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, prej ditës së marrjes kopjes së të njëjtit në veçori për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin. Ankesa i ushtrohet Gjykatës Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet Gjykatës Themelore në Prizren.